

## MARRËVESHJE PËR BLERJE KUOTE

Ne Tirane, sot me date 10.06.2024 (dymije e njëzet e katër), lidhet kjo marrëveshje per shitblerje kuotash ndermjet paleve si ne vijim:

1. **Shoqëria "Green Coast" Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, me seli në Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 3, Kati 1, Tirane, Shqiperi", përfaqësuar nga administratori Z. Armando Alicanaj, shtetas shqiptar, lindur më 05.10.1979, në Fier, mbajtës i pasaportës me nr. BC5216331, dhe me numër personal H91005012U, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (më poshtë referuar si "**Shites**")
2. **Shoqëria "Great View Hospitality" Sh.p.k**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M22120034N, me seli në adresë rruga "Muhamed Gjollësja", Pallati i Ri "Foleja e Gjellbër", Hyrja F, Kati 5, Ap. F51, prane UEM, Tirane, përfaqësuar rregullisht nga administrator Z. Mirsad Zymeri (më poshtë referuar si "**Blerës**")

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshtë:

### **vijon:**

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **855,100 LEK** (tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Seaside Hotel II sh.p.k.**", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti Nr. 31, Tiranë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M11419021G, përfaqësuar nga Administratori Z. Armando Alicanaj ("**Kuota**").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të **1 (një)** kuotë me një vlerë nominale prej **855,100 LEK** (tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë **Seaside Hotel II sh.p.k.**, dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabartë me **960,000 LEK** (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë lekë), (këtu e tutje referuar si "**Çmimi**").
3. Blerësi do të paguajë brenda dites se nesërme të firmosjes së kësaj kontrate çmimin e plotë prej **960,000 LEK** (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë lekë), në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:

Emri i Bankës: Tirana Bank SH.A.

Titullari i llogarisë: Green Coast Sh.p.k.

NR.Llogarie: 0110-319705-101

IBAN: AL49 2061 1011 0000 1103 1970 5101

Monedha: ALL

4. Shitësi në këtë mënyrë deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguroese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe ne cdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e

Kuotës së mësipërme.

Në çdo rast vetëm pagesa e plotë e Çmimit nga Blerësi është kusht thelbësor për përfitimin e pronësisë së Kuotës nga Blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshje. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.

6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2), (3) dhe (5) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
9. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshje.
10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje me përmbajtje dhe fuqi të njëjtë ligjore.

#### PALET KONTRAKTORE

SHITËSI

*Armando Alicanaj*

**Green Coast Sh.p.k.**

përfaqësuar nga Z. Armando Alicanaj



GREEN COAST  
L41329038D

BLERËSI

*Mirsad Zymeri*

**Great View Hospitality Sh.p.k.**

përfaqësuar nga Z. Mirsad Zymeri



**SEASIDE HOTEL II SH.P.K**  
**RRUGA "DERVISH HIMA", PALLATI AMBASADOR 3, KATI 4, APARTAMENTI NR.31.TIRANË**  
**NUIS: M11419021G**

---

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

Sot, më 09/06/2024 në orën 11.00, në selinë e Shoqërisë “Seaside Hotel II” sh.p.k. (më tej referuar si “Shoqëria”), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishëm:

- **Green Coast Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 3, Kati 1, Tiranë, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, e cila zotëron 1 kuotë të Shoqërisë Seaside Entertainment qe përfaqëson 100 % (njëqind përqind) te kapitalit te Shoqerise (Ortaku i Vetëm), ne kete asamble e përfaqësuar rregullisht nga Z. Armando Alicanaj, shtetas shqiptar, lindur me 05.10.1979, ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar mbajtës i pasaportës me nr. BC5216331 dhe me nr. personal H91005012U, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, në cilësinë e Administratorit.

Z. Armando Alicanaj i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**REND I DITËS**

- I. Miratimi i shitjes së kuotës që përfaqëson 100% ( njëqind për qind ) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë Seaside Hotel II.**

\*\*\*\*\*

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se Green Coast sh.p.k zotëron 1 ( një) kuotë me vlerë nominale 855,100Lek ( tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind lekë) e cila përfaqëson 100% ( njëqind për qind ) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë Seaside Hotel II sh.p.k. Kryetari propozon shitjen e kuotës që përbën 100% ( njëqind përqind ) të kapitalit të kësaj shoqërie tek shoqëria Great View Hospitality sh.p.k një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë regjistruar si person juridik në QKB ( Qendra Kombëtare e Bisnesit) me numër unik identifikimi M22120034N, me seli në adresë rruga “Muhamed Gjollësja”, Pallati i Ri “ Foleja e Gjelber”, Hyrja F, Kati 5, Ap F51, pranë UEM, Tiranë. Vlera e shitjes së kuotës 100% propozohet të jetë 960,000 LEK (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

**VENDOS:**

- A. Të miratojë shitjen e kuotës e cila përfaqëson 100% ( njëqind për qind ) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë që Green Coast sh.p.k zotëron në cilësinë e ortakut të vetëm pranë shoqërisë Seaside Hotel II tek shoqëria Great View Hospitality sh.p.k (M22120034N) në shumen prej 960,000 LEK (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë lekë)
- B. Të autorizojë administratorin e shoqërisë që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të zbatojë dhe regjistrojë këtë vendim pranë autoriteteve përkatëse, të negociojë, nënshkruajë marrëveshjen për shitjen e kuotës te shoqëria blerëse dhe të nënshkruajë çdo dokument tjetër të nevojshëm lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.30.

**ORTAKU I VETEM  
GREEN COAST SH.P.K.  
KRYETAR**

*Armando Alicana*

**ARMANDO ALICANAJ**

**SEKRETAR**

*Rozana Kodrari*  
**ROZANA KODRARI**



12:51

4G 71



## Transaction Details

**G** GREEN COAST SH.P.K

Original amount

**-960 000,00 ALL**



Beneficiary's account

0110319705101

Payment reference

Pagese MarreveshjesperBlerjeKuote

Transaction date

13-06-2024

Booking date

13-06-2024

Account amount

-960 000,00 ALL

Transaction type

Internal transfer

Transaction status

Booked

Transaction ID

2024-06-130022FFCA409

 **TIRANA BANK**  
DEGA GARDA - 0110

SHOW LESS DETAILS